



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 87 date 22/11/2002

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “ç” të Ligjit Nr.8549 dt.11.11.1999 “Statusi i Nënpunësit Civil”, Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2002”, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë së Tiranës
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, miratohet struktura e re organizative e Bashkisë së Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur
3. Numri maksimal i punonjësve të aparatit të Bashkisë së Tiranës është:

-Punonjës me kontratë -	70
-Punonjës, nënpunës civilë -	279

4. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 shfuqizohet pjesa që lidhet me miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij Vendimi
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETARI

Leonidha TOSKA

